



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovaki Institut Prave

FOL

11/2023

# INTEGRITETI I PROCESIT TË ZGJEDHJES SË REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË GJILANIT

(Raport i monitorimit të procesit të zgjedhjes së rektorit të ri të Universitetit  
"Kadri Zeka" në Gjilan)

Korrik, Prishtinë 2023



Autorë: Instituti i Kosovës për Drejtësi/ Lëvizja Fol

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Implementuar nga:



#### RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi  
Prishtinë  
E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)  
[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

#### RRETH FOL

FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje.

LEVIZJA FOL, RR. Andrea Gropa, No.35,  
10000 Prishtinë  
[info@levizjafol.org](mailto:info@levizjafol.org)  
[www.levizjafol.org](http://www.levizjafol.org)

Korrik, 2023  
Prishtinë, Republika e Kosovës

# PËRMBAJTJA

<b>04</b>	1. Përmbledhje ekzekutive
<b>05</b>	2. Historiku i shkurtër i shpalljes së konkursit për rektor në UKZ
<b>06</b>	3. Gjetjet e OJQ-ve në procesin e zgjedhjes së rektorit të UKZ-së
<b>06</b>	3.1 Përbërja jo e plotë e KD-së gjatë gjithë procesit
<b>07</b>	3.2 Intervista e pa strukturuar nga KD
<b>07</b>	3.3 Procedura e votimit deri në tre raunde
<b>08</b>	3.4 Mungesa e një Rregullore të veçantë për procedurën e zgjedhjes së rektorit
<b>09</b>	4. Sjelljet jo etike dhe gjuha e papërshtatshme e anëtarit të KD-së
<b>09</b>	4.1 Anëtari i KD-së, Urtak Hamiti tentoi të largoi monitoruesit nga procesi
<b>10</b>	4.2 Gjuha e papërshtatshme e Hamitit ndaj anëtarëve të tjerë të KD-së
<b>12</b>	5. Kërkesa e Gjinollit për largimin e videos së publikuar nga "Betimi për Drejtësi", ku shihet anëtari Hamiti duke tentuar ti largojë monitoruesit nga procesi
<b>14</b>	6. Rekomandimet

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Organizatata Jo-Qeveritare Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe Lëvizja FOL (Tutje: Koalicioni), si organizata të specializuara në fushën e sundimit të ligjit në Kosovë dhe me përvojë të gjatë në monitorimin e proceseve rekrutues, janë pajtuar që së bashku të bëjnë monitorimin e procesit të përzgjedhjes dhe emërimit të rektorit të ri të Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan.

Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan pas zhvillimit të procesit të intervistave me katër (4) kandidatë, me 6 korrik 2023, ka zgjedhur Artan Dermakun, rektor të këtij Universiteti. Në konkursin e shpallur me 7 qershor 2023, kishin aplikuar pesë (5) kandidatë. Aplikimet i kishin dorëzuar, Dukagjin Leka (UKZ), Xhevat Sopi (UKZ), Artan Dermaku (UKZ), Fadil Osmani (UKZ) dhe Xhavit Islami (AAB). Pas shqyrtimit të kandidaturave nga Komisioni i Shqyrtimit të Aplikacioneve, KD-së i ka rekomanduar vetëm katër (4) kandidatë, kjo pasi është refuzuar kandidatura e Xhavit Islamit. Gjetjet e Koalicionit të OJQ-ve konsistojnë në atë se edhe pse përbërja e Këshillit Drejtues është me shtatë (7) anëtar, procesi i intervistimit të kandidatëve kishte filluar me përbërje të gjashtë (6) anëtarëve të KD-së, pasi anëtari i KD-së Urtak Hamiti nuk kishte qenë i pranishëm që nga fillimi i procesit të intervistimit të kandidatëve. Tutje, edhe pse i njëjti nuk ka qenë pjesë e tërë procesit të intervistimit të kandidatëve për rektor, i njëjti ka marrë pjesë në procesin e votimit për kandidatët për rektor.

Sipas Koalicionit, është e qartë që sipas Statutit të UKZ-së dhe Rregullores së Punës nuk kërkohet poentimi i intervistave me pikë dhe se të gjitha Universitetet në përgjithësi e ndjekin këtë praktikë. Por, është e rëndësishme që karakteri i intervistës të rregullohet me Rregulloren e veçantë të zgjedhjes së rektorit. Në këtë drejtim IKD dhe FOL rekomandojnë që në proceset e ardhshme të plotësohet rregullativa ligjore ku do të eliminohen të gjitha këto mangësi. Po ashtu, IKD dhe Lëvizja FOL konsiderojnë se procedurat e zgjedhjes dhe votimit për rektor duhet të jenë të qarta dhe të mos lënë hapësira për keqinterpretim të dispozitave. KD-ja duhet të miratojë rregullore të veçanta për zgjedhjen e rektorit ku duhet të parashihen edhe detajet më të vogla në procedurën e zgjedhjes apo shkarkimit të rektorit të UKZ-së.

Gjithashtu, IKD dhe Lëvizja FOL, kërkojnë nga organet drejtuese që të merren masa ndaj Hamitit për shkak të qasjes së tij jo etike dhe joprofesionale ndaj monitoruesve dhe tentimit të tij për t'i penguar monitoruesit. Si dhe Koalicioni i OJQ-ve konsiderojnë që Gjinolli ka dështuar të ushtrojë funksionin e tij si kryesues dhe të sigurojë mbarëvajtjen e mbledhjes së KD-së ashtu siç e kërkon Statuti i UKZ-së dhe Rregullorja e punës së KD-së.

Ministria e Arsimit të ndërmarr masa ndaj kryesuesit Ilir Gjinolli për shkak të kërkesës së tij për ta larguar videon nga ueb-faqja e "Betimit për Drejtësi", kjo pasi kërkesa e tillë paraqet ndërhyrje në punën e Organizatës dhe për më tepër, cenon rëndë parimin e transparencës dhe të drejtën e interesit publik që të jenë të informuar për procese të tilla të rëndësishme.

## 2. Historiku i shkurtër i shpalljes së konkursit për rektor në UKZ

Këshilli Drejtues i Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan, në mbledhjen e mbajtur më 7 qershor 2023 ka marrë vendim për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e rektorit të ri të këtij universiteti.[1] Ky konkurs ka qenë i hapur 15 ditë, ku kanë aplikuar pesë (5) kandidatë. Aplikimet i kanë dorëzuar këta kandidatë: Dukagjin Leka (UKZ), Xhevat Sopi (UKZ), Artan Dermaku (UKZ), Fadil Osmani (UKZ) dhe Xhavit Islami (AAB). Pas shqyrtimit të kandidatëve nga Komisioni i Shqyrtimit të Aplikacioneve, KD-së i ka rekomanduar vetëm katër (4) kandidatë, kjo pasi është refuzuar kandidatura e Xhavit Islamit.

Sipas Komisionit, katër (4) kandidatët e rekomanduar kanë plotësuar kriteret e kërkuara për rektor të UKZ-së, si: përvojën e dëshmuar në mësimdhënie akademike, kërkimore, shkencore dhe gradën e profesorit të rregullt, profesorit të asociuar ose profesorit asistent si dhe përvojë të dëshmuar menaxhuese universitare. Në procesin e intervistimit të kandidatëve për rektor të zhvilluar me 6 korrik 2023, kandidatët para anëtarëve të KD-së kanë paraqitur vizionin e tyre gjithëpërfshirës për zhvillimin e strategjisë së ardhshme të Universitetit dhe për qasjen e tyre menaxhuese.

Megjithatë, edhe pse KD në përbërjen e vet ka shtatë (7) anëtarë, anëtari i zgjedhur nga Senati i UKZ-së, Urtak Hamiti nuk ka qenë i pranishëm në tërë intervistat e zhvilluara të kandidatëve për rektor, për më tepër edhe pse i njëjti nuk ka marrë pjesë në procesin e intervistimit, ai ka marrë pjesë në procesin e votimit të zgjedhjes së rektorit.

Pas zhvillimeve të tre (3) raundeve dhe me shumë diskutim mes anëtarëve të KD-së për aspektet procedurale, Prof. Artan Dermaku ka arritur të marrë votat e nevojshme për t'u zgjedhur rektor i UKZ-së, ku mandati i tij parashihet të fillojë me 1 tetor 2023, për një periudhë prej katër (4) vitesh me mundësi vazhdimi.

Ky proces është monitoruar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Lëvizja FOL dhe BIRN.

## 3. Gjetjet e OJQ-ve në procesin e zgjedhjes së rektorit të UKZ-së

### 3.1 Përbërja jo e plotë e KD-së gjatë gjithë procesit

Këshilli Drejtues i UKZ-së, në përbërjen e tij ka shtatë (7) anëtarë, prej të cilëve, Ilir Gjinolli (kryesues), Arta Istrefi-Jahja (zëvendës kryesues) dhe Agron Hajdari janë anëtarë të emëruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Ndërsa, katër (4) të tjerë, Urtak Hamiti, Nerxhivane Krasniqi, Selim Daku dhe Nexhat Shkodra janë anëtar të zgjedhur nga Senati i UKZ-së.

Procesi i intervistimit të kandidatëve ka filluar me përbërje të gjashtë (6) anëtarëve të KD-së, pasi anëtari Urtak Hamiti nuk ka qenë i pranishëm që nga fillimi i procesit të intervistimit të kandidatëve.

Sipas Rregullores mbi Punën e Këshillit Drejtues të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, të gjithë anëtarët e KD-së janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e këtij organi. Përgjatë kësaj, neni 7, par 3 ka përcaktuar, se: "Para se të fillojë mbledhja e Këshillit Drejtues, anëtarët do të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes, e cila është pjesë integrale e procesverbalit. Anëtari i Këshillit Drejtues mund të mungojë nga mbledhja për shkak të arsyeshme. Për mosardhje në mbledhje, anëtari i Këshillit duhet ta njoftojë me kohë kryesuesin".

[1] Shih: Vendimi nr. 02/1079, dt.08.06.2023.

Megjithatë, edhe pse pjesëmarrja në mbledhje të KD-së është e obligueshme, përjashtimisht rrethanave të arsyeshme, një gjë e tillë nuk ka ndodhur me rastin e zgjedhjes së rektorit të ri të UKZ-së. Kjo pasi, anëtari Urtak Hamiti nuk ka marrë pjesë në tërë procesin e intervistimit të kandidatëve për rektor të UKZ-së. I njëjti ka qenë prezent vetëm te kandidati i tretë Artan Dermaku ku ka qëndruar shumë pak duke u rikthyer në mes të intervistës së kandidatit të katër për rektor Fadil Osmanit. Tutje, edhe pse i njëjti nuk ka qenë pjesë e tërë procesit të intervistimit të kandidatëve për rektor, i njëjti ka marrë pjesë në votimin për kandidatët për rektor.[2]

Për më tepër, KD në fillim të mbledhjes kishte njoftuar se një nga anëtarët është duke ardhur në mbledhjen e KD-së, megjithatë kryesuesi Gjinolli nuk ka njoftuar nëse anëtari Hamiti kishte treguar se për cilat shkaqe nuk është paraqitur në mbledhje[3] dhe po ashtu nga monitorimi i IKD-së nuk është parë nëse KD e ka evidentuar në procesverbal kohën kur ka ardhur dhe kohën kur është larguar nga mbledhja Urtak Hamiti, ashtu siç kërkohet edhe me Rregulloren e Punës së KD-së.[4] Pos Hamitit, gjatë procesit të intervistimit të kandidatëve ka pasur edhe anëtarë të tjerë që kanë dal jashtë nga salla, për periudha të shkurtra kohore 3 deri në 5 min. Ndër ta, IKD dhe FOL kanë evidentuar Selim Dakun dhe Nerxhivane Krasniqin.

### 3.2 Intervista e pa strukturuar nga KD

Procesi i intervistimit të katër (4) kandidatëve për rektor të UKZ-së është zhvilluar në objektin e UKZ-së. KD ka vendosur që kandidatët të kenë në dispozicion nga 30 minuta për të prezantuar shkurtimisht një biografi të tyre dhe punën në UKZ si dhe vizionin e tyre për Universitetin dhe për qasjen e tyre menaxhuese në rast se të njëjtit zgjedhen rektor të universitetit.

Gjatë monitorimit të këtij procesi, IKD dhe Lëvizja FOL kanë gjetur se KD nuk ka pasur një formular të unifikuar të pyetjeve të njëjta për secilin kandidat për rektor dhe as poentim për intervistat. Vetëm katër (4) anëtarë të KD-së kanë parashtruar pyetje dhe vetëm anëtari Selim Daku ka parashtruar pyetjet e njëjta për secilin kandidat për rektor.

Ndërsa, dy nga anëtarët Nerxhivane Krasniqi dhe Nexhat Shkodra nuk kanë parashtruar pyetje fare për kandidatët për rektor. Kurse, Urtak Hamiti në ato pak minuta ku ka marrë pjesë në procesin e intervistimit nuk ka parashtruar asnjë pyetje.

IKD dhe Lëvizja FOL konsiderojnë që intervistat e kandidatëve për rektor të UKZ-së më tepër kanë qenë një formalitet se sa një proces ku do të duhej të dëgjohej dhe sfidohej vizioni i kandidatëve për rektor për të ardhmen e këtij universiteti. KD nuk ka arritur që në këtë proces të ndërtojë një intervistë të strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët. Mos parashtrimi i pyetjeve të njëjta paraqet trajtim jo të barabartë në mes të kandidatëve. Edhe përkundër kësaj, edhe pse disa nga anëtarët nuk kanë parashtruar pyetje dhe anëtari Hamiti nuk ka marrë pjesë në tërë procesin e intervistimit, në fund të gjithë kanë votuar për kandidatin e tyre të preferuar.

Megjithatë, është e qartë se sipas Statutit të UKZ-së dhe Rregullores së Punës nuk kërkohet poentimi i intervistave me pikë dhe se të gjitha Universitetet në përgjithësi e ndjekin këtë praktikë. Është e rëndësishme që karakteri i intervistës të rregullohet me Rregulloren e veçantë të zgjedhjes së rektorit. Në këtë drejtim IKD dhe FOL rekomandojnë që në proceset e ardhshme të plotësohet rregullativa ligjore ku do të eliminohen të gjitha këto mangësi.

[2] "Artan Dermaku, rektor i ri i Universiteti të Gjilanit "Kadri Zeka". Betimi për Drejtësi. 6 korrik 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/artan-dermaku-rektor-i-ri-i-universiteti-te-gjilanit-kadri-zeka/>). (Qasur për herë të fundit më 8 korrik 2023).

[3] **Shënim:** Në nenin 7, paragrafi 3 ndër të tjera thuhet se: "Anëtari i Këshillit Drejtues mund të mungojë nga mbledhja për shkaqe të arsyeshme. Për mosardhje në mbledhje, anëtari i Këshillit duhet ta njoftojë me kohë kryesuesin".

[4] **Shënim:** Sipas nenit 7, pika 3 e Statutit të KD-së: "Para se të fillojë mbledhja e Këshillit Drejtues, anëtarët do të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes, e cila është pjesë integrale e procesverbalit".

### 3.3 Procedura e votimit deri në tre raunde

Procesi për zgjedhjen e rektorit të UKZ-së është zhvilluar në tre (3) raunde votimi. Kjo pasi asnjë nga kandidatët nuk ka arritur qysh në raundin e parë ti sigurojë votat e nevojshme për tu zgjedhur rektor i UKZ-së.

Pas prezantimit të vizioneve të katër (4) kandidatëve, në radhën e parë të votimit asnjë nga kandidatët nuk ka arritur ti marrë shumicën e votave, për më tepër kandidati Artan Dermaku ka marrë tre (3) vota, Dukagjin Leka ka marrë dy (2) vota dhe Xhevat Sopi po ashtu dy (2) vota, kurse kandidati Fadil Osmani nuk ka marrë asnjë votë.

Sipas nenit 26, par 3 të Statutit të UKZ-së dhe nenit 16, par 2 të Rregullores së Punës së KD-së: "Rektori zgjedhet me shumicën absolute (shumicën e anëtarëve të përgjithshëm me votim të fshehur) në pajtim me dispozitat e këtij Statuti. Në rast se asnjë kandidat nuk fiton këtë shumicë në radhën e parë të votimit atëherë dy (2) kandidatët me numrin më të madh të votave kualifikohen në votimin e dytë. Nëse asnjëri nga dy (2) kandidatët nuk fiton shumicën absolute tre (3) herë radhazi, procedura e zgjedhjes përsëritet nga fillimi, ashtu siç është paraparë në këtë Statut".[5]

Pasi asnjë nga kandidatët nuk ka arritur që të sigurojë shumicën absolute të votave (së paku 4 vota) në radhën e parë, atëherë sipas statutit dhe Rregullores është dashur që të kualifikohen dy kandidatët me numër më të madh të votave për raundin e tretë.

Edhe pse Statuti dhe Rregulloja janë të paqarta me situatën e lartcekur kur dy (2) kandidatë janë me numër të barabartë të votave, KD-ja ka vendosur që këta dy kandidatë të shkojnë në radhën e dytë të votimit, e pastaj kandidati më i votuar të përballej me Artan Dermakun, i cili në radhën e parë kishte marrë më shumë vota se kandidatët e tjerë.

Një situatë e tillë kishte krijuar paqartësi edhe mes anëtarëve të KD-së, por që në fund të njëjtit kishin vendosur që të shkonin me tre (3) raunde të votimit.

Nga praktika e sistemeve elektorale, në rastin e votave të barabarta për kualifikim të mëtejshëm aplikohen dy variante kryesore:

1. Rivotimi deri në tre raunde
2. Hedhja e shortit

Zakonisht, në praktikë kur kandidatët mbestin me vota të barabarta aplikohet më së shumti varianti i rivotimit deri në tre (3) raunde, e kjo në rastin konkret është aplikuar për dy kandidatët e mbetur me vota të barabarta që garonin për kualifikim në raundin e dytë.

Për këtë situatë, Sekretari i UKZ-së, iu ka rekomanduar anëtarëve të KD-së që në rastin e kandidatëve me vota të barabarta, të zbatohet varianti i rivotimit. Ky rekomandim i sekretarit është miratuar nga Këshilli Drejtues. Pas kësaj, është zhvilluar radha e dytë e votimit mes kandidatëve Dukagjin Leka dhe Xhevat Sopi, ku pas numërimit të votave, Dukagjin Leka ka marrë 3 vota ndërsa Xhevat Sopi 4 vota. Pas radhës së tretë, kandidatë Artan Dermaku ka arritur të marrë 4 vota ndërsa Xhevat Sopi 2 vota.[6]

[5] Shih nenin 26 par 3 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan dhe nenin 16, par 2 të Rregullores së Punës së Këshillit Drejtues.

[6] "Artan Dermaku, rektor i ri i Universitetit të Gjilanit "Kadri Zeka". Betimi për Drejtësi. 6 korrik 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/artan-dermaku-rektor-i-ri-i-universiteti-te-gjilanit-kadri-zeka/>). (Qasur për herë të fundit më 8 korrik 2023).



IKD dhe Lëvizja FOL konsiderojnë se procedurat e zgjedhjes së rektorit duhet të jenë të qarta dhe të mos lënë hapësira për keqinterpretim të dispozitave. KD duhet të miratojë rregullore të veçanta për zgjedhjen e rektorit ku duhet të parashihen edhe detajet më të vogla në procedurën e zgjedhjes apo shkarkimit të rektorit të UKZ-së.

### 3.4 Mungesa e një Rregullore të veçantë për procedurën e zgjedhjes së rektorit

IKD dhe FOL nuk kanë gjetur nëse KD-ja ka nxjerrë një Rregullore të veçantë për procedurën e zgjedhjes dhe mandatin e rektorit, pasi e njëjta nuk figuron askund në ueb-faqen zyrtare të UKZ-së dhe për më tepër KD-ja asnjëherë gjatë procesit nuk i ishte referuar një rregullore të tillë. Sipas Statutit të UKZ-së, nenit 26, par 6, parasheh ndër të tjera thuhet se: “Këshilli drejtues, në konsultim me Senatin, nxjerrë rregulloren për procedurën e zgjedhjes dhe mandatin e rektorit”. Po ashtu, edhe konkursi i shpallur për rektor të UKZ-së nuk përmban asnjë dispozitë të kësaj rregullore, i njëjti bazohet vetëm në Ligjin mbi Arsimin e Lartë dhe Statutin e UKZ-së.[7]

Mos nxjerrja e një rregullore të veçantë përkundër obligimeve të statutit dhe referimi në akte të përgjithshme të këtij procesi tregon për qasjen jo profesionale dhe mungesën e përgjegjësisë institucionale të KD-së. Prandaj, janë paraqitur situatat, ku nuk ka pasur formular të unifikuar të pyetjeve të njëjta, nuk ka pasur vlerësim dhe poentim individual nga anëtarët e KD-së dhe është paraqitur situata e votave të barabarta.

Po të ishte miratuar rregullorja e veçantë ashtu siç kërkohet me statut, këto situata nuk do të paraqiteshin gjatë zgjedhjes së rektorit të UKZ-së. Megjithatë, KD-ja nuk ka respektuar as afatin kohor të statutit, ku në nenin 233 pika 2, ishte përcaktuar që: “Brenda gjashtë (6) muajve nga miratimi i këtij Statuti, Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan dhe njësitë akademike e organizative duhet ti hartojë dhe miratojë aktet dhe rregulloret për zbatimin e këtij Statuti”.

IKD dhe FOL e kanë të qartë që në përgjithësi edhe Universitetet tjera nuk kanë të miratuar një Rregullore të veçantë për zgjedhjen e rektorit, megjithatë kjo procedurë është e rregulluar vetëm me statute dhe Rregullore të Punës së Këshillit Drejtues, e që secili universitet do duhej të kishte procedura të detajuara të zgjedhjes së rektorit.

## 4. Sjelljet jo etike dhe gjuha e papërshtatshme e anëtarit të KD-së

### 4.1 Anëtarit i KD-së, Urtak Hamiti tentoi të largoi monitoruesit nga procesi

Pas përfundimit të procedurës së intervistimit të të gjithë kandidatëve për rektor, anëtarët e KD-së fillimisht emëruan komisionin për të organizuar procesin e votimit për rektor ku u vendos njëzëri që kryesuese e komisionit për votimin e rektorit të jetë Arta Istrefi-Jahaj si dhe dy anëtarët Agron Hajdari dhe Selim Daku.

Pas formimit të komisionit anëtarët e Këshillit Drejtues shkuan në pauzë, dhe me tu rikthyer, Urtak Hamiti i është drejtuar fillimisht sekretarit të Universitetit Vaxhid Sadriu duke e pyetur se a ka votuar KD-ja që monitoruesit të jenë prezent në procesin e votimit për rektor. Edhe pse i njëjti u informua nga Sadriu që monitoruesit janë lejuar nga kryesuesi Gjinolli dhe se nuk ka pasur vendim.

[7] Shih: Vendimi nr. 02/1079, dt.08.06.2023.

Me të marrë konfirmimin Hamiti ka kërkuar nga monitoruesit disa herë radhazi që të largohen nga salla edhe pse monitoruesit i kanë sqaruar të njëjtit që kanë marrë konfirmim për monitorimin e këtij procesi nga kryesuesi Gjinolli. Qasja e Hamitit ndaj monitoruesve ka qenë e ashpër duke kërkuar nga të njëjtit që me patjetër të largohen nga salla. Ai është drejtuar monitoruesve edhe me fjalët “Përrjashta dil, a do me t'nxjerr unë a, përrjashta?”[8]

Edhe përkundër që mbledhjet e KD-së janë të hapura për publikun, IKD dhe Lëvizja FOL disa ditë para procesit kanë kërkuar konfirmimin nga kryesuesi i KD-së, Ilir Gjinolli që tu lejohet monitorimi i këtij procesi.

IKD dhe Lëvizja FOL, kërkojnë nga organet drejtuese që të merren masa ndaj Hamitit për shkak të qasjes së tij jo etike dhe joprofesionale ndaj monitoruesve dhe tentimit të tij për ti penguar monitoruesit që ta përcjellin këtë mbledhje me interes të madh publik.

## 4.2 Gjuha e papërshtatshme e Hamitit ndaj anëtarëve të tjerë të KD-së

Gjatë procesit të monitorimit është vërejtur se anëtari Hamiti ka përdorur gjuhë të papërshtatshme ndaj anëtarëve të KD-së. Pasi kishte përfunduar procedura e intervistimit të të gjithë kandidatëve dhe me tu futur në procedurën e votimit për rektor, Urtak Hamiti i'u është drejtuar anëtarëve të Këshillit me fjalët “Unë e zgjedhi sot, e zgjedhi Dukagjin Lekën.” Ky prononcim i Hamitit duke e bërë votën publike, bie ndesh me Statutin e KD-së, konkretisht me nenin 26, par 3, ku kërkohet që votimi të jetë i fshehtë.[9]

Tutje, gjatë marrjes së fletëvotimit për të votuar, Hamiti i ishte drejtuar anëtares Arta Istrefi-Jahaj me fjalët “E pandehur shihemi në gjyq”.

Por, këto nuk kanë qenë fjalët e vetme të Hamitit gjatë procesit të votimit. Në një moment Hamiti iu është drejtuar të gjithë anëtarëve të Këshillit me fjalët “Çka po rrini bre serioz, çka u bo, çka jeni duke u tutë, çka po tutni bre, çka po tutni o vëlla, çka keni, kadal bre, katër, tre-katër, tre qaty jem prap ne këtu jemi.”

Tutje, i njëjti pasi që shkohet në raundin e dytë të votimit sërish i'u drejtohet të gjithë anëtarëve të këtij Këshilli me fjalët “Ose ka marrëveshje ose ka konfront, unë mezi nuk pres jam i lindur e i rritur për konfront ose jemi krejt bashkë ose nuk jemi askund.”

Në raundin e tretë të votimit pasi që Hamiti merr fletëvotimin nga kryesuesja Arta Istrefi-Jahaj dhe vëren se në rubrikën për tu votuar nuk është Dukagjin Leka por vetëm Xhevat Sopi dhe Artan Dermaku, merr fletëvotimin dhe para anëtares së Këshillit e gris të njëjtin. Gjithashtu krejt në fund të procesit të votimit Hamiti i drejtohet sekretarit të Universiteti Vaxhid Sadriut me fjalët “ Ja kthejnë shpinën Bajram Kosumit, hej bre, ktheja-ktheja veç tani koqitësh (përballesh) me neve e ne jemi të poshtër, ne Llapjant nuk jemi të drejtë, ne jem të poshtër, ne nuk lujmë fer, ne lujmë keq, ktheja, ktheja Bajramit shpinën e kur të vish tek ne tani e kaqyrim, te ne ndihma kushton.”

Kjo sjellje e Hamitit ka dëmtuar rëndë integritetin e procesit të zgjedhjes së rektorit të UKZ-së. Kjo pasi sjellja e tillë e të njëjtit bie në kundërshtim me standardet etike dhe profesionale e për më tepër është në kundërshtim edhe me vetë Rregulloren e Punës së KD-së.[10] Edhe përkundër që kryesuesi i KD-së, është personi përgjegjës për veprimet dhe sjelljet e anëtarëve të KD-së gjatë mbledhjes, i njëjti nuk ka ndërmarrë ndonjë masë ndaj Hamitit për sigurimin e mbarëvajtjes së punës në mbledhjen e KD-së.

[8] “Urtak Hamiti tenton ti pengojë monitoruesit dhe mediat në procesin e zgjedhjes së rektorit në Gjilan”. Betimi për Drejtësi. 6 korrik 2023. (Shih linkun: [IKD dhe Lëvizja FOL konsiderojnë se procedurat e zgjedhjes së rektorit duhet të jenë të qarta dhe të mos lënë hapësira për keqinterpretim të dispozitave. KD duhet të miratojë rregullore të veçanta për zgjedhjen e rektorit ku duhet të parashihen edhe detajet më të vogla në procedurën e zgjedhjes apo shkarkimit të rektorit të UKZ-së.](#)) (Qasur për herë të fundit më 9 korrik 2023).

[9] Neni 26, par 3: “Rektori zgjedhet me shumicën absolute (shumicën e anëtarëve të përgjithshëm me votim të fshehur) në pajtim me dispozitat e këtij statuti”

[10] Neni 10, par 4. “... Në mbledhjet e Këshillit askush nuk mund të diskutojë pa e marrë fjalën nga kryesuesi i mbledhjes”

Sipas nenit 18 të Rregullores së Punës së KD-së, kryesuesi ka të drejtë të shqiptojë:

- Vërejtje
- Marrjen e fjalës
- Largimin nga mbledhja

Megjithatë kryesuesi Gjinolli këto masa nuk i ka përdorur ndaj anëtarit Hamiti edhe përkundër gjuhës së papërshtatshme të këtij të fundit dhe sjelljes jo etike ndaj monitoruesve kur ka tentuar ti largojë nga procesi i monitorimit.

IKD dhe Lëvizja FOL, konsiderojnë që Gjinolli ka dështuar të ushtrojë funksionin e tij si kryesues dhe të sigurojë mbarëvajtjen e mbledhjes së KD-së ashtu siç e kërkon Statuti i UKZ-së dhe Rregullorja e punës së KD-së.

## **5. Kërkesa e Gjinollit për largimin e videos së publikuar nga “Betimi për Drejtësi”, ku shihet anëtari Hamiti duke tentuar ti largojë monitoruesit nga procesi**

“Betimi për Drejtësi” në të njëjtën ditë kur ishte zhvilluar procesi i zgjedhjes së rektorit të UKZ-së, kishte publikuar një video ku ekspozoheshin veprimet e anëtarit Hamiti duke tentuar ti largojë monitoruesit nga salla ku po zhvillohej procesi.[11]

Me të përfunduar procesi, në videon ku ishte publikuar, kryesuesi i Këshillit Drejtues të UKZ-së, Ilir Gjinolli fillimisht kishte komentuar në rrjetin social “Facebook” e pastaj kishte shkruar e-mail tek monitoruesi i IKD-së duke kërkuar që të largohej video nga publikimi.

Në komunikimin elektronik përmes e-mailit ai kishte shkruar: *“Falemnderit per pjesemarrjen ne procesin e zgjedhjes se Rektorit te ri te UKZ. Megjithse jemi marrevesh se nuk mund te beni video, ju keni postuar nje video nga procesi te cilen une e konsideroj ilegale dhe te demshme per misionin e organizates suaj. Prandaj ju lutem me miresi qe ta terheqni nga faja e IKD ne Facebook.”*

IKD rikujton se asnjëherë nuk ka pasur ndonjë marrëveshje mes monitoruesve dhe KD-së që të mos incizohet në procesin e votimit, përkundrazi ka qenë kërkesë e anëtares Arta Istrefi-Jahaj që të mos incizohet, mirëpo asnjëherë nuk ka pasur një miratim apo aprovim nga ana monitoruesve. Për më tepër anëtarët e KD-së nuk kanë votuar që një proces i tillë të jetë i mbyllur, pra nuk ka pasur asnjë vendim me të cilin do duhej të arsyetohej se pse monitoruesit nuk mund ta monitorojnë apo incizojnë procesin e votimit të zgjedhjes së rektorit të UKZ-së.

Po ashtu, në kohën kur është bërë video ku shihet anëtari Hamiti duke tentuar ti largojë monitoruesit nga salla, nuk ka pasur as kërkesë për mos incizim sepse kanë qenë momentet para fillimit të procesit të votimit dhe para fillimit të mbledhjes, pasi në atë kohë anëtarët e KD-së veç sa ishin kthyer nga pauza, kjo shihet më së miri në videon e publikua nga “Betimi për Drejtësi”, ku kryesuesi nuk ishte prezent.

IKD një kërkesë të tillë të kryesuesit Gjinolli e konsideron shqetësuese, kjo pasi pikërisht Gjinolli ka qenë personi që e ka aprovuar kërkesën e IKD-së për monitorimin e procesit të tillë. Ai në përgjigjen përmes komunikimit elektronik ka deklaruar se: *“.....Meqenese si pas Rregulloes per pune e KD neni 6 paragraafi 6: Mbledhjet e KD jane te hapura per publikun, jeni te miresearchur per te marre pjese ne Mbledhjen e Keshillit Drejtues te UKZ ne te cilen do te zgjedhet rektori i ri”.*

[11] [“Urtak Hamiti tenton ti pengojë monitoruesit dhe mediat në procesin e zgjedhjes së rektorit në Gjiilan”. Betimi për Drejtësi. 6 korrik 2023. \(Shih linkun: mbledhjet e Këshillit askush nuk mund të diskutojë pa e marrë fjalën nga kryesuesi i mbledhjes” \). \(Qasur për herë të fundit më 9 korrik 2023\).](#) (Qasur për herë të fundit më 9 korrik 2023).

Përpjekja e Gjinollit për të larguar videon nga ueb-faqja e IKD-së, paraqet ndërhyrje në punën e Organizatës dhe për më tepër, cenon rëndë parimin e transparencës dhe të drejtën e interesit publik që të jenë të informuar që konkurset e tilla të zhvillohen me transparencë të plotë.

Kërkesa e tillë e Gjinollit bie ndesh gjithashtu me karakterin publik të mbledhjeve të Këshillit Drejtues, ku në nenin 6, pika 6 të Rregullores sqarohet qartë se mbledhjet janë të hapura për publikun përpos kur kemi një vendim tjetër nga Këshilli dhe se të njëjtat përcjellën përmes mjeteve audiovizuale.[12]

IKD sqaron se monitorimi i procesit të zgjedhjes së rektorit të UKZ-së, ka qenë publik dhe se pamjet e publikuara nga "Betimi për Drejtësi" nuk cenojnë asnjë të drejtë të personave të tjerë por vetëm se dëshmojnë sjelljet jo etike dhe jo profesionale të Komisionit.

Monitorimi i procesit të zgjedhjes së rektorit të UKZ-së, nuk është procesi i parë i monitoruar nga mediat dhe OJQ-të, ngjashëm është vepruar edhe në rastin e zgjedhjes së profesor Qerim Qerimit në pozitën e rektori të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", pas miratimit të agjendës së intervistimit dhe votimit të kandidatëve, në shërbim të transparencës së procesit, përmes e-mailit të Universitetit të Prishtinës ka ftuar ambasadat e huaja në Republikën e Kosovës dhe Organizatat e Shoqërisë Civile që të monitorojnë procesin e zgjedhjes së rektorit[13]. Mediat dhe Shoqëria Civile kishin monitoruar këtë proces edhe në kohën e votimit.[14]

Po ashtu, IKD më herët kishte monitoruar edhe shumë procese të tjera me interes publik, ndër to edhe procesin e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit, ku në këtë proces intervistat e kandidatëve përveç që ishin monitoruar ato edhe ishin incizuar dhe transmetuar në Radio Televizionin e Kosovës (RTK). Andaj, kërkesa të tilla cenojnë rëndë interesin publik, dhe për më tepër shpërfaqin tendencën për ti fshehur sjelljet jo etike dhe jo profesionale të këtij komisioni e në veçanti të anëtarit Hamiti, aq më tepër kur kërkesat e tilla vijnë nga kryesuesi i Këshillit i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e mbledhjes së KD-së.

[12] Shënim: "Mbledhjet e Këshillit Drejtues janë të hapura për publikun, pos në rastet kur Këshilli Drejtues vendos ndryshe. Ato duhet të përcillen përmes mjeteve audiovizuale" thuhet sipas nenit 6 pika 6 e kësaj rregullore.

[13] "Procesi i zgjedhjes së rektorit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". 10 nëntor 2022. (Shih linkun: <https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,6,1790> ).(Qasur për herë të fundit më 9 korrik 2023).

[14] "Me 6 vota për, Qerim Qerimi, është zgjedhur rektor i ri i UP-së". KTV. 21 nëntor 2022. (Shih linkun: <https://www.youtube.com/watch?v=My7psVSaY3g> ). (Qasur për herë të fundit më 9 korrik 2023).

## 6. Rekomandime

Duke marrë parasysh rrethanat dhe gjendjen faktike të përshkruar më lartë, IKD dhe Fol rekomandojnë:

- Proceset e zgjedhjes së rektorit duhet të zhvillohen me transparencë të plotë nga fillimi i procesit e deri në votimin dhe zgjedhjen e rektorit.
- IKD dhe FOL i rekomandojnë UKZ-së që të miratojë Rregulloren e veçantë për zgjedhjen e rektorit, ashtu siç kërkohet me statutin e UKZ-së.
- Rregullorja e veçantë të parasheh qartë detajet dhe procedurën e votimit të zgjedhjes së rektorit.
- Me rregullore të përcaktohet karakteri i intervistës së kandidatëve për rektor të UKZ-së dhe të parashihet formularë i veçantë me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët në mënyrë që të ketë qasje të barabartë ndaj të gjithë kandidatëve.
- KD të ndërmarr masa ndaj Hamitit për shkak të qasjes së tij jo etike dhe joprofesionale ndaj monitoruesve dhe tentimit të tij për ti penguar monitoruesit nga salla.
- Ministria e Arsimit të ndërmarr masa ndaj kryesuesit Ilir Gjinolli për shkak të kërkesës së tij për ta larguar videon nga ueb-faqja e IKD-së, kjo pasi kërkesa e tillë paraqet ndërhyrje në punën e Organizatës dhe për më tepër, cenon rëndë parimin e transparencës dhe të drejtën e interesit publik që të jenë të informuar për procese të tilla të rëndësishme.

[1] Shënim: "Mbledhjet e Këshillit Drejtues janë të hapura për publikun, pos në rastet kur Këshilli Drejtues vendos ndryshe. Ato duhet të përcillen përmes mjeteve audiovizuale" thuhet sipas nenit 6 pika 6 e kësaj rregullore.

[1] "Procesi i zgjedhjes së rektorit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". 10 nëntor 2022.

(Shih linkun: <https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,6,1790>). (Qasur për herë të fundit më 9 korrik 2023).

[1] "Me 6 vota për, Qerim Qerimi, është zgjedhur rektor i ri i UP-së". KTV. 21 nëntor 2022.

(Shih linkun: <https://www.youtube.com/watch?v=My7psVSaY3g>). (Qasur për herë të fundit më 9 korrik 2023).

